



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS

UDHËZUES

Nr. 5, datë 18.03.2020

“Mbi konkurrencën në tregjet e rrjeteve dhe shërbimeve për komunikimet elektronike”¹

I. Të përgjithshme

1. Neni 2 i Ligjit 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” i ndryshuar, parashikon se në fushën e zbatimit të ligjit janë edhe ndërmarrjet publike dhe ndërmarrjet të cilave u janë dhënë nga shteti të drejta ekskluzive ose të drejta të veçanta.
2. Legjislacioni evropian² i ka kërkuar Shteteve Anëtare të shfuqizonin të drejtat ekskluzive për ofrimin e shërbimeve të telekomunikacionit, fillimisht për shërbime të tjera, sikurse telefoninë e zërit, shërbimet satelitore dhe radio komunikimet e lëvizshme, dhe pastaj të krijonin gradualisht kushtet për konkurrencën e plotë në tregjet e telekomunikacionit.
3. Në kuadër të zhvillimeve që kanë shënuar procesin e liberalizimit dhe hapjen graduale të tregjeve të telekomunikacionit në Evropë që nga viti 1990, përkufizime të caktuara duhet të rregullohen, në mënyrë që të pasqyrojnë zhvillimet më të fundit teknologjike në fushën e telekomunikacionit, për të marrë parasysh fenomenin e konvergencës që ka formuar teknologjia e informacionit, media dhe industria e telekomunikacionit gjatë viteve të fundit.
4. Ky Udhëzues i referohet koncepteve të tilla si “shërbimeve të komunikimit elektronik” dhe “rrjeteve të komunikimeve elektronike”. Këto përkufizime të reja janë të domosdoshme për të marrë parasysh fenomenin e konvergencës, duke sjellë së bashku nën një përkufizim të vetëm të gjitha shërbimet e komunikimit elektronik dhe / ose rrjetet të cilat merren me përcjelljen e sinjaleve me tel, radio, optikë ose mjete të tjera elektromagnetike (d.m.th. fikse, wireless, televizion kabllor, rrjete satelitore). Kështu që, transmetimi i programeve radio dhe televizive, duhet të njihet si një shërbim i komunikimit elektronik dhe rrjetet e përdorura për një transmetim të tillë, duhet të njihen si rrjete të komunikimeve elektronike.

¹ 32002L0077, Commission Directive 2002/77/EC of 16 September 2002 on competition in the markets for electronic communications networks and services (*Official Journal L 249*, 17/09/2002 P. 0021 – 0026);

32002L0077, Direktiva e Komisionit 2002/77/ EC e 16 shtatorit 2002 mbi konkurrencën në tregjet e rrjeteve dhe shërbimeve për komunikimet elektronike (*Fletore Zyrtare L 249*, 17/09/2002 P. 0021 – 0026)

² Direktiva 90/388 / EEC



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I KONKURENCËS

Për më tepër, duhet të bëhet e qartë se përkufizimi i ri i rrjeteve të komunikimeve elektronike, gjithashtu mbulon rrjetet e fibrave, të cilat mundësojnë që palët e treta, të transmetojnë sinjale duke përdorur pajisjet e tyre.

5. Në këtë kontekst, duhet të hiqen të drejtat ekskluzive dhe të veçanta për dispozitat e të gjitha rrjeteve të komunikimeve elektronike, jo vetëm ato për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe duhet të sigurohet që ndërmarrjet kanë të drejtë të ofrojnë shërbime të tilla. Përkufizimi i rrjeteve të komunikimeve elektronike gjithashtu nënkupton se nuk lejohet të kufizohet e drejta e një operatori për të krijuar, zgjeruar dhe / ose siguruar një rrjet kabllor me arsyetimin se një rrjet i tillë mund të përdoret edhe për transmetimin e programeve të radios dhe televizionit. Në veçanti, të drejtat e veçanta/speciale ose ekskluzive që kufizojnë përdorimin e rrjeteve elektronike të komunikimit për transmetimin dhe shpërndarjen e sinjaleve televizive janë në kundërshtim me dispozitat ligjore, pasi ato kanë efektin e lejimit të një ndërmarrje me pozitë dominuese të kufizojë “prodhimin, tregjet ose zhvillimin teknik”.
6. Në zbatim të parimit të proporcionalitetit, në lidhje me ofrimin e shërbimeve të komunikimit elektronik dhe krijimin dhe ofrimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike duhet ti nënshtrohen një regjimi të përgjithshëm autorizimi. Shërbimet ose rrjetet e komunikimit elektronik, duhet të ofrohen në bazë të një autorizimi të përgjithshëm. Një pale e dëmtuar, duhet të ketë të drejtën për të kundërshtuar një vendim që e parandalon atë nga ofrimi i shërbimeve ose rrjeteve të komunikimit elektronik përpara një organi të pavarur dhe para një gjykate. Është një parim themelor, që çdo individ ka të drejtë të ketë mbrojtje efektive gjyqësore sa herë që një masë shtetërore shkel të drejtat e tij.
7. Autoritetet publike, mund të ushtrojnë ndikim dominues në sjelljen e ndërmarrjeve publike, si rezultat ose i rregullave mbi bazën e të cilave ushtron aktivitetin kjo ndërmarrje ose mënyrës së shpërndarjes së aksioneve. Prandaj, kur kontrollohen operatorët e rrjetit vertikalisht të integruar, të cilët operojnë rrjete që kanë krijuar nën të drejta të veçanta ose ekskluzive, duhet të sigurohet që, për të shmangur shkeljet e mundshme të rregullave të konkurrencës, operatorë të tillë, kur ata gëzojnë një pozitë dominuese në tregun përkatës, të mos diskriminojnë në favor të veprimtarive të tyre. Për këtë arsye duhet të ndërmerren të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar çdo diskriminim midis operatorëve të tillë vertikalisht të integruar dhe konkurrentëve të tyre.
8. Ky udhëzues duhet të sqarojë gjithashtu parimin në lidhje me komunikimet celulare dhe personale, duke parashikuar që nuk duhet të jepen të drejta ekskluzive ose të veçanta të përdorimit të frekuencave të radios dhe që të drejtat e përdorimit të atyre frekuencave duhet të caktohen sipas procedurave objektive, jo-diskriminuese dhe transparente. Kjo duhet të



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I KONKURENCËS

mos cenojë kriteret specifike dhe procedurat e miratuara për dhënien e të drejtave të tilla ofruesve të shërbimeve me përmbajtje transmetimi radio ose televizive, me qëllim ndjekjen e objektivave të interesit të përgjithshëm.

9. Çdo skemë që shërben për të ndarë koston neto të ofrimit të detyrimeve të shërbimit universal, duhet të bazohet në kriteret objektive, transparente dhe jo-diskriminuese dhe do të jetë në përputhje me parimet e proporcionalitetit dhe të mos shtrembërimin të tregut. Shtrembërimi i tregut në nivelin më të ulët, do të thotë që kontributet duhet të rikuperohen në atë mënyrë që sa më shumë të jetë e mundur të minimizohet ndikimi i barrës financiare që bie mbi përdoruesit fundorë, për shembull duke shpërndarë kontribute sa më gjerësisht të jetë e mundur.
10. Kur të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga konventat ndërkombëtare që krijojnë organizata ndërkombëtare satelitore, janë në përputhje me rregullat e konkurrencës, duhet të ndërmerren të gjitha hapat e duhur për të eliminuar papajtueshmëri me rregullat e konkurrencës.
11. Ky udhëzues përcakton detyrimin për të siguruar që ofruesit dominant/kryesorë të rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe shërbimeve telefonike të disponueshme për publikun, të operojnë rrjetin e tyre publik të komunikimit elektronik dhe rrjetin televiziv kabllor si persona juridikë të veçantë/ente juridike më vete.

Neni 1

Përkufizime

12. “Rrjet i komunikimeve elektronike”³ janë sistemet e transmetimit dhe, nëse ekzistojnë, sistemet e komutimit ose rrugëzimit dhe burime të tjera, përfshirë elementet e rrjetit që nuk janë aktive, të cilat lejojnë përcjelljen e sinjaleve nëpërmjet përcjellësve, radios, mjeteve optike ose mjeteve të tjera elektromagnetike, duke përfshirë rrjetet satelitore, rrjetet fikse tokësore (me komutim të qarqeve ose me komutim të paketave, përfshirë internetin), rrjetet e lëvizshme tokësore, sistemet e kabllave elektrike, në raste kur ato përdoren për transmetimin e sinjaleve, rrjetet e përdorura për transmetimet radiotelevizive dhe rrjetet kabllore televizive, pavarësisht nga tipi i informacionit të përcjellë.
13. “Rrjet i komunikimeve publike” është një rrjet i komunikimeve elektronike, që përdoret, tërësisht ose kryesisht, për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike, të

³ Ligj Nr.9918, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, neni 3 “Përkufizime, pika 36



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I KONKURRENCËS

disponueshme për publikun dhe që suporton transferimin e informacionit ndërmjet pikave fundore të rrjetit.

14. “Shërbim i komunikimeve elektronike”⁴ është shërbimi, normalisht përkundrejt një pagese, i cili përftohet, tërësisht ose pjesërisht, nga përcjellja e sinjaleve përmes rrjeteve të komunikimeve elektronike, që përfshin shërbimet e telekomunikacioneve dhe shërbimet e transmetimit në rrjetet e përdorur për transmetime radiotelevizive dhe në rrjetet e televizionit kabllor, por duke përjashtuar shërbimet, të cilat ofrojnë përmbajtje nëpërmjet rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike, ose që ushtrojnë kontroll redaksional ndaj përmbajtjes së ofruar për transmetimin, duke përdorur rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike. Ai nuk përfshin shërbimet e shoqërisë së informacionit, të cilat nuk përbëhen, tërësisht ose pjesërisht, nga përcjellja e sinjaleve në rrjetet e komunikimeve elektronike.
15. “Shërbime të komunikimit elektronik të disponueshëm” janë shërbimet e komunikimit elektronik të disponueshëm për publikun;
16. “Të drejta ekskluzive” janë të drejtat që një i jepen një ndërmarrjeje përmes ndonjë instrumenti legjislativ, rregullator ose administrativ, duke i rezervuar asaj të drejtën për të ofruar një shërbim të komunikimeve elektronike ose për të ndërmarrë një veprimtari të komunikimit elektronik, në një zonë të caktuar gjeografike;
17. “Të drejta të veçanta” janë të drejtat që i jepen një numri të kufizuar ndërmarrjesh përmes ndonjë instrumenti legjislativ, rregullator ose administrativ i cili, brenda një zone të caktuar gjeografike:
 - cakton ose kufizon në dy ose më shumë numrin e ndërmarrjeve të tilla të autorizuara për të siguruar një shërbim të komunikimeve elektronike ose për të ndërmarrë një veprimtari të komunikimit elektronik, ndryshe nga sa parashikojnë kriteret objektive, proporcionale dhe jo-diskriminuese, ose
 - u jep ndërmarrjeve, ndryshe nga sa parashikojnë kriteret, avantazhe ligjore ose avantazhet rregullatorë, të cilat ndikojnë në mënyrë thelbësore në aftësinë e çdo ndërmarrjeje tjetër për të ofruar të njëjtin shërbim të komunikimit elektronik ose për të ndërmarrë të njëjtën veprimtari të komunikimeve elektronike, në të njëjtën zonë gjeografike, në kushte thelbësore të barabarta/të njëjta;
18. “Rrjeti i stacionit satelitor tokësor” është një konfigurim i dy ose më shumë stacioneve tokësore që bashkëveprojnë me anë të një sateliti;

⁴ Ligj Nr.9918, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” neni 3 “Përkufizime”, pika 43



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I KONKURENCËS

19. “Rrjetet televizive kabllore” është çdo infrastrukturë kryesisht me bazë teli, e krijuar fillimisht për shpërndarjen e transmetimit të radios ose televizionit në publik.

Neni 2

Të drejtat ekskluzive dhe të veçanta për rrjetet e komunikimeve elektronike dhe shërbimet e komunikimeve elektronike

20. Nuk duhet të jepen ose të qëndrojnë në fuqi të drejta ekskluzive ose të veçanta për krijimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike ose për ofrimin e shërbimeve të komunikimit elektronik publike në dispozicion.
21. Duhet të merren masat e nevojshme për të siguruar që çdo ndërmarrje ka të drejtë të ofrojë shërbime të komunikimit elektronik ose të krijojë, zgjerojë ose ofrojë rrjete të komunikimeve elektronike.
22. Nuk duhet të vendosen kufizime në ofrimin e shërbimeve të komunikimit elektronik mbi rrjetet e komunikimeve elektronike të krijuara nga ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike, mbi infrastrukturën e ofruara nga palët e treta, ose me anë të mjeteve të rrjeteve të shkëmbimit apo lehtësirave të tjera.
23. Një autorizim i përgjithshëm i dhënë një ndërmarrjeje për të ofruar shërbime të komunikimeve elektronike ose për të krijuar dhe / ose ofruar rrjete të komunikimeve elektronike, si dhe kushtet e bashkangjitura në to, të bazohet në kritere objektive, jo-diskriminuese, proporcionale dhe transparente.
24. Duhet të jepen arsyet për çdo vendim të marrë që parandalon një ndërmarrje nga ofrimi i shërbimeve ose rrjete të komunikimeve elektronike. Çdo palë e dëmtuar duhet të ketë mundësinë të kundërshtojë një vendim të tillë përpara një organi të pavarur nga palët e përfshira dhe në fund të fundit para një gjykate.

Neni 3

Ndërmarrjet publike të integruara vertikalisht

25. Ndërmarrjet publike të integruara vertikalisht që ofrojnë rrjete të komunikimeve elektronike dhe që janë në një pozitë dominuese, të mos diskriminojnë në favor të veprimtarive të tyre.

Neni 4

Të drejtat e përdorimit të frekuencave



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I KONKURRENCËS

26. Në lidhje me kriteret specifike dhe procedurat e miratuara për dhënien e të drejtave të përdorimit të radio frekuencave për ofruesit e shërbimeve me përmbajtje transmetimi radio ose televizive me qëllim ndjekjen e objektivave të interesave të përgjithshme:

1. Nuk duhet të jepen të drejta ekskluzive ose të veçanta të përdorimit të radio frekuencave për ofrimin e shërbimeve të komunikimit elektronik.
2. Caktimi i frekuencave të radios për shërbimet e komunikimit elektronik do të bazohet në kritere objektive, transparente, jo-diskriminuese dhe proporcionale.

Neni 5

Detyrimet e shërbimit universal

27. Çdo skemë kombëtare, që shërben për të ndarë koston neto të ofrimit të detyrimeve të shërbimit universal, bazohet në kritere objektive, transparente dhe jo-diskriminuese dhe duhet të jetë në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe të kufizimit sa më pak të tregut. Në veçanti, kur detyrimet e shërbimit universal u imponohen plotësisht ose pjesërisht ndërmarrjeve publike që ofrojnë shërbime të komunikimit elektronik, kjo do të merret në konsideratë në llogaritjen e çdo kontributi në koston neto të detyrimeve të shërbimit universal.

Neni 6

Satelitët

28. Nuk duhet të këtë ndalime rregullatore ose kufizime në ofrimin e kapacitetit të segmentit hapësinor për çdo operator të autorizuar të rrjetit satelitor të tokës dhe duhet të autorizohet ofruesi i segmentit hapësinor për të verifikuar që rrjeti i stacionit satelitor tokësor për përdorim në lidhje me segmentin hapësinor të ofruesit në fjalë është në përputhje me kushtet e publikuara për akses/qasje në kapacitetin e segmentit hapësinor të një personi të tillë.

Neni 7

Rrjetet televizive kabllore



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I KONKURENCËS

29. Çdo ndërmarrje që ofron rrjetin publik të komunikimeve elektronike, nuk duhet të përdorë rrjetin e saj televiziv kabllor duke përdorur të njëjtin person juridik siç përdor për rrjetin tjetër të komunikimit elektronik publik, kur ndërmarrje e tillë:

- (a) përfiton nga të drejtat e veçanta; dhe
- (b) ka pozitë dominuese në një pjesë të konsiderueshme të tregut në ofrimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike publike dhe shërbimeve telefonike publikut të disponueshme; dhe
- (c) operon një rrjet televiziv kabllor i cili është krijuar nën të drejtën e veçantë/speciale ose ekskluzive në të njëjtën zonë gjeografike.

30. Shprehja "shërbime telefonike në dispozicion të publikut" do të konsiderohet sinonim me termin "shërbime telefonike publike të zërit".

Neni 8

Hyrja në fuqi

Ky Udhëzues hyn në fuqi menjëherë pas miratimit nga Komisioni i Konkurrencës dhe mund të rishikohet për të pasqyruar ndryshime në legjislacionin në fuqi, zhvillime të rëndësishme ose përvojë të mëtjshme gjatë zbatimit të rregullave të konkurrencës.